



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komora Farmaceuta Kosova
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr.Br.No. 78 Dt 05.10.20



ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA

KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1 me nënparagrafet 1.12, 1.13, 1.17, 1.18 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësore nr. 04/L-150; nenit 20, paragrafi 13, 14 22 të Statutit të OFK-së; nenit 41 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031 dhe nenit 10, paragrafi 5 të rregullorës mbi punën e organeve kolegjiale të Odës së Farmacistëve të Kosovës nr. 2019, përmes votimit qarkullues të datës 02/10/2020, nxjerr këtë :

V E N D I M

- I. Taksa administrative e paraparë ne vendimin nr.42 të vitit 2019 prej 5 Euro për mos përmbajtje të afatit për anëtarësim, të mos zbatohet për vitin 2020.
- II. Të gjithë anëtarëve të cilët kanë paguar taksën nga pika I-rë gjatë vitit 2020, pagesa i njihet si parapagim për anëtarësim për vitin 2021.
- III. Aplikimi i taksës nga paragrafi I-rë fillon nga viti 2021.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Arsyetim

Kuvendi i Odës së Farmacistëve të Kosovës në takim e mbajtur me 29 Qershorë 2019 ka aprovuar taksat administrative për shërbimet e OFK-së, ku është paraparë dhe taksa prej 5 Euro per muaj shtesë për mos përmbajtje të afateve të përmushjes së taksës administrative për anëtarësim.

Situata e krijuar nga pandemia COVID 19 ka ndikuar ne keqësimin e pozitës ekonomike të qytetarëve dhe anëtarëve tanë.

Prandaj duke pasur parasysh situatën e krijuar ekonomike pas paraqitjes së COVID 19 dhe dispozitat e lërtëcekura, Kuvendi i ODës së Farmacistëve vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

I'dërgohet:

- Anëtarëve të OFK-së
- Shërbimit Profesional

Kryetari i OFK-së

Dr.sc. Arianit Jakupi





ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA

KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1 me nënparagrafet 1.1 në lidhje me nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësore nr. 04/L-150; nenit 20, paragrafi 1, në lidhje me nenin 15, paragrafi 7 të Statutit të OFK-së; nenit 41 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031 dhe nenit 10, paragrafi 5 të rregullorës mbi punën e organeve kolegjiale të Odës së Farmacistëve të Kosovës nr. 2019, përmes votimit qarkullues të datës 02/10/2020, nxjerr këtë :

V E N D I M

- I. Për vazhdimin e vendimi të Kuvendit të OFK-së nr. 30 i datës 05/05/2020 për barazvlerësimin e aktiviteteve të EVP-së të cilat mbahen online me pikët e përcaktuar për aktivitetet profesionale të cilat mbahen me praninë fizike të pjesëmarrësit.
- II. Ky vendim mbetet në fuqi në afat të pacaktuar deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër.
- III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Kuvendi i Odës së Farmacistëve të Kosovës në votimin qarkullues të datës 05/05/2020, ka vendosur që barazvlerësimi nga pika I-rë e dispozitivit të jetë i vlefshëm deri më 30 Shtator 2020.

Edhe pse situata me pandeminë COVID 19, javëve të fundit po shkon drejt normalizimit, organizimi i aktiviteteve në masë është i ndaluar si masë për parandalimin e përhapjes së COVID 19.

Prandaj me qëllim të lehtësimit dhe mundësimin të aktiviteteve të EVP-së, Kuvendi i OFK-së vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

I'dërgohet:

- Shërbimit Profesional



Kryetari i OFK-së

Dr.sc. Arianit Jakupi.